



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISE, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Nr. .Prot.

Tiranë, më . .2024

Lënda : **Ftesë për Negociatë** “*Promovimi i mundësive të Formimit Profesional dhe Punësimit për Punëkërkuessit e papunë*”, *Migrantët e kthyer dhe të Rinjtë në Shqipëri*”, mbështetur nga FCDO

Drejtuar : **ORGANEVE TË MASMEDIAS/AGJENSIVE TË SPECIALIZUARA**

Bazuar në Vendimin Nr. 1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore”, Drejtoria Qendrore e Agjencise Kombetare të Punesimit dhe Aftesive e Përgjithshme ju dërgon këtë ftesë për pjesëmarrje për realizimin e shërbimit të prodhimit spoteve ndërgjegjësuese dhe transmetimit të këtyre spoteve në mediat vizive me temë “*Promovimi i mundësive të Formimit Profesional dhe Punësimit për Punëkërkuessit e papunë*”, *Migrantët e kthyer dhe të Rinjtë në Shqipëri*”, mbështetur nga FCDO

Kërkojmë të na vini në dispozicion ofertën tuaj për shërbimin e kërkuar sipas përcaktimeve si më poshtë:

Qëllimi i kësaj fushate është:

Projekti “*Promovimi i mundësive të Formimit Profesional dhe Punësimit për Punëkërkuessit e papunë*”, *Migrantët e kthyer dhe të Rinjtë në Shqipëri*”, i financuar prej Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, që vepron përmes Zyrës për Punë të Jashtme, Komonuelthit & Zhvillim (“FCDO”), dhe zbatuar nga Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit, dhe Numer Projekti IMRF ABT 2324 006, synon të kontribuojë në pjesëmarrjen aktive dhe nxitjen e punëkërkuessve, në tregun e punës, veçanërisht tek grupet e të rinjve 15-29 vjeç, të vajzave dhe grave, si dhe emigrantëve të kthyer në Shqipëri.

Projekti “*Promovimi i mundësive të Formimit Profesional dhe Punësimit për Punëkërkuessit e papunë*, *Migrantët e kthyer dhe të Rinjtë në Shqipëri*” është përgatitur si përgjigje ndaj Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, specifikisht në linjë me objektivin:

“ Ndërmjetësim më gjithëpërfshirës i punësimit”

Përshkrimi:

“Prodhimi dhe transmetimi i videove ndërgjegjësues (SPOTE) në kuadër të promovimit dhe informimit të publikut “Promovimi i mundësive të Formimit Profesional dhe Punësimit për Punëkërkuessit e papunë”, Migrantët e kthyer dhe të Rinjtë në Shqipëri”,

Këto fushata do të përqendrohen në tërheqjen e vëmendjes të të rinjve në shërbimet dhe programet që ofrohen nga institucionet kombëtare të punësimit dhe aftësive, duke përfshirë trajnimet, praktikat në vend dhe shërbimet e këshillimit për karrierë.

Synimi i ndërhyrjes është që të krijojë një mjedis ku të rinjtë ndihen të motivuar, të përkrahur për të qëndruar në vend dhe për të kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm për të gjithë.

Shërbimet që kërkohen të realizohen:

PRODUKTI 1. Hartimi i Strategjisë së Promovimit, e cila synon ndërtimin e një plani për media vizive dhe plani veprimi të përshtatur për zbatimin e produkteve të krijuara me qëllim përmbushjen e objektivave të fushatës.

Përgatitja dhe prezantimi i një strategjie për media vizive deri në 2-mujore dhe një fushatë me një plan të qartë veprimi. Konsultim me target grupin gjatë fazës së projektimit ose testim i produkteve të planifikuara. Strategjia duhet të zhvillohet duke mbajtur në konsideratë, por pa u limituar, elemente që lidhen me:

- **Segmentimin e target grupit të synuar** dhe krijimin e profileve të detajuara të audiencës për të kuptuar më mirë nevojat dhe interesat e tyre.
- **Kanale të Komunikimit**,
- **Aktivitetet e Promovimit**, materialet promovuese, fokus grupe me targetin e synuar,
- **Idete e fushates,mesazhet që do te percillen. .**

Me qëllim krijimin e një identiteti të fushatës së promovimit, duhet te propozohet gjithashtu imazhi i saj dhe mesazhi qe do te percjelle duke synuar te jetë i dallueshëm, i qëndrueshëm dhe i përcjellë në mënyrë efektive tek audiencia e synuar

PRODUKTI 2. Prodhimi gjithsej i 4(kater) spote- video promovuese të prodhuara dhe dorëzuara, të detajuara si vijon:

- Prodhimi i 2(dy) spote dëshmi me veprim të drejtpërdrejtë (25-30) sekonda secila për promovimin e shërbimeve dhe programeve të punësimit.Kompania duhet të krijojë konceptin dhe storyboardin e videos promovuese, i mbështetur nga rekomandimet që AKPA do të mundësojë. Video do të shoqërohet me voiceover dhe me titra. Video duhet të shoqërohet me slloganin kryesor, si dhe logot e institucioneve zbatuesve dhe donatorit.
- Prodhimi i 2(dy) spote-video dëshmi (25-30 sekonda) me histori sukcesi të të rinjve te perfshire ne sistemin e arsimit te mesem profesional dhe te kualifikimeve. Kompania duhet të krijojë konceptin dhe storyboardin e videos promovuese,i mbështetur nga rekomandimet qe AKPA do te mundesoje. Spotet do të shoqërohen me voiceover dhe me titra. Ato duhet të percjellin slloganin kryesor, si dhe logot e institucioneve zbatuesve dhe donatorit, ne kete

rast Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, që vepron përmes Zyres për Punë të Jashtme, Commonwealth & Zhvillim (“FCDO”)

Spotet duhet të jenë në formate për transmetim televiziv. Spotet duhet të përmbajnë pamje dhe mesazhe nga sistemi i punësimit dhe aftësimit, si shkollat e mesme, nxënësit që frekuentojnë, arritjet e tyre, investimet më të mëdha që janë bërë në vend për të rritur mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mesëm profesional, pamje dhe proçese të punës së specialistëve të punësimit, arritjeve dhe rasteve konkrete të punësimit.

Spotet duhet të kenë këto karakteristika:

- Të kenë disa skena dhe të përfshijne personazhe njerëzore
- Jo të animuar, por mund të përmbajnë animacione të formës grafike;
- Audio/narracion shoqërues me regjistrim profesional;
- Cilësia full HD;
- Kohëzgjatja: jo më e shkurtër se 30 sekonda secili.

Operatori duhet të marrë përsipër:

- Përpara përgatitjes së spotit operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një “storyboard” ku të shpjegojë ideimin dhe krijimin e spoteve;
- Prodhimin e spotit në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve;
- Regjistrimin, pastrimin, dhe montimin e zërit narrativ;
- Shoqërimin e zërit me muzikë shoqëruese dhe efekte të tjera audio;
- Muzika duhet të jetë origjinale ose e shoqëruar me të drejtat e përdorimit;
- Renderizimin e spotit në format 16X9 (HD) i gatshëm për transmetim;
- Dorëzimin e spotit në 3 DVD, në format origjinal të pakonvertuar.

PRODUKTI 3. Transmetim i videove ndërgjegjësuere (SPOTE) në televizion duke synuar informimin e publikut të gjerë për një periudhë 45 ditë.

Transmetimi duhet të ketë këto karakteristika:

- Transmetimi i 4 (kater) spoteve televizive secili në 3 kanale kryesore në vend, të mbështetura nga 3 ose më shumë kanale informative (ndër më të ndjekurat);
- Frekuenca: cdo ditë për çdo kanal, ku një nga spotet të jetë ndërmjet fashës orare 15:30 deri 23:00;
- Periudha e transmetimit: 45 dite;
- Totali i transmetimeve: Jo më pak se 360 transmetime për të gjithë periudhën e transmetimit.

Operatori duhet të marrë përsipër:

- Përpara transmetimit operatori duhet të prezantojë një media plan ku të jenë përcaktuar televizionet e përzgjedhura, programacioni sipas fashave orare, listën e spoteve në transmetim, sekondazhin total të transmetimit, numrin total të spoteve, dhe numrin e spoteve që do të transmetohen në fashën orare 15:30 – 23:00;

- Monitorimin e transmetimit nga një palë e tretë e pavaruar duke garantuar transmetimin sipas media planit.

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet e përcaktuara më lart në funksion të objektit “Prodhimin dhe transmetimin i videove ndërgjegjësues (SPOTE) në kuadër të *“Promovimi i mundësive të Formimit Profesional dhe Punësimit për Punëkërkuessit e papunë”, Migrantët e kthyer dhe të Rinjtë në Shqipëri*”,

Operatori duhet të dorëzojë në Agjencinë Kombetare të Punësimit dhe Aftësive, materialet e përgatitura në 2 (dy) kopje hard copy dhe në 3 (tre) kopje DVD.

Fondi limit në dispozicion për realizimin e shërbimeve të mësipërme, do të jetë:

- **15,125,800** (Pesëmbëdhjetë million e njëqind e njëzet e pese mijë e teteqind) lekë pa TVSH

Afati i fundit për paraqitjen e ofertave, pranë Drejtorisë Qendrore të AKPA, në zyrën e Protokollit, nga Agjencitë e specializuara, është data 18.10.2024 ora 10:00.

Paraqitja e ofertës pas këtij orari nuk do të pranohet.

Agjencia e specializuar që do të paraqesë konfirmimin për vazhdimësinë e negociatave, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e një Vetëdeklarate me shkrim të subjektit në ditën e hapjes së Ofertës.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme të pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore. Në çdo rasi, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga subjekti, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike/terma reference.
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 3
- d. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1+Shtojca 2
- e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me çertifikimet si vijon:

ISO 27001:2023 ose ekuivalente
ISO 9001:2015 ose ekuivalente

Për të vërtetuar një aktivitet ekonomik pozitiv të qëndrueshëm, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Per te vertetuar nja aktivitet pozitiv të qendrueshem (bilancet e shoqërise të mos kene rezultuar me humbje per dy vite te njepanjeshme).Operatori ekonomik duhet te paraqese:Kopje te çertifikuara te bilanceve te 3(tre) viteve te fundit ushtrimore,

2021,2022,2023 te paraqitur ne autoritetet perkatese, Dega e Tatim-Taksave dhe te konfirmuara nga ky autoritet.

- Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin vërtetim per xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros minimale vjetore per te paktem nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% e vleres se parashikuar te kontrates. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te paktën nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor.

3. Kapaciteti teknik:

Përsa i përket kapacitetit teknik,Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- Kompania duhet të ketë kryer më parë të paktën (nje) kontrate të ngjashme me institucione publike, private ose organizata ndërkombëtare në tre vitet e fundit.
- Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave per sherbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në vlerë totale jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së ftesës për negociim.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë/ vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Deklaratë për përmbushjen e kriterëve teknike nga subjekti, për prodhimin dhe transmetimin e spoteve promovues, në mediat televizive të licensuara për transmetim brenda territorit të Shqipërisë.

B. Operatori ekonomik duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

Për të vërtetuar se operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme per realizimin ne kohe e cilesi te kontrates si dhe per te garantuar zhvillimin cilesor te aktivitetit, operatori ekonomik duhet te disponoje staf te kualifikuar te siguruar/me kontrate me kerkesat si me poshte|:

Të ketë të punësuar një personel prej jo më pak se 7 (shtatë) personash për tre muajt e fundit nga data e paraqitjes së ofertes.

- Të ketë të punësuar minimumi 2 (dy) dizenjues grafikë, të diplomuar ose të certifikuar për dizajn/art grafik ose film, post produksion, montazh dhe të kenë qënë pjesë e stafit në periudhën tre muajt e fundit nga data e paraqitjes së ofertes.
- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) agjent publiciteti të specializuar, me diplomë për administrim biznesi, ekonomik, marketing ose shkencë komunikimi dhe pjesë e stafit në periudhën tre muajt e fundit nga data e paraqitjes së ofertes.
- Të paktën një menaxher projekti përgjegjes për realizimin e këtij projekti për mbajtjen e marrëdhënieve me autoritetin kontraktor dhe monitorimin e tij.
- Të paktën një rregjizor përgjegjes për drejtimin artistik të skenave të xhirimeve të spoteve me eksperience me mbi 5 vjet.
- Të paktën një drejtor kreativ përgjegjes për krijimin e idese dhe skenarit me të paktën 5 vjet eksperience.

Për të vërtetuar punësimin e personelit të sipërpermendur, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontrate pune të vlefshme, CV, diploma, deshmi, çertifikate, librese pune, listepagesat e çertifikuara.

Për të vërtetuar punësimin e personelit të sipërpermendur, operatori ekonomik duhet të paraqesë listepagesat e certifikuara, për periudhën tre muajt e fundit.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rremë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

C. Kriteret e vlerësimit:

Mbështetur bazë të VKM Nr. VKM Nr 1195, datë 5.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për Kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore” pika 12, vlerësimi do të bëhet në bazë të pikëve.

- Kapaciteti Teknik dhe professional : 20 pikë
- Propozimi Teknik dhe metodologjia: 30 pikë
- Oferta financiare: 50 pikë

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë pa TVSH

Ndërsa, Agjencia e specializuar si e klasifikuar më e mira përpara se të përzgjidhet si oferta e suksesshme në bazë të kushteve të përcaktuara, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues të parashikuar në Kriteret e përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit.

Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën origjinale dhe dokumentacionin përkatës, të futur në një zarf jo transparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e operatorit dhe të shënuar në ftesën për ofertë, brenda afatit të caktuar.

Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave:

Çdo Agjenci e specializuar ftohet të dorëzojë ofertë. Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf jotransparent, të firmosur, vulosur, me emrin dhe adresën e subjektit negociues, me shënimin “Mos e hapni, me përjashtim të rastit kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo **përpara datës 18.10.2024, ora 10:00**”.

Ato duhet të dorëzohen nga përfaqësuesit e operatorit ekonomik, pranë zyrës së protokollit të AKPA, brenda orës në datën e përcaktuar. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe nuk do të merren për shqyrtim.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në monedhën Lek pa TVSH dhe TVSH do të jetë e përcaktuar në një zë të veçantë në ofertë.

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor: Emri: Drejtoria Qendrore e Agjencise Kombetare te Punesimit dhe Aftesive, Adresa: Bulevardi “Balram Curri”,1004, Tiranë

Adresa e Internetit: www.akpa.gov.al. e-mail:kontakt@akpa.gov.al.

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195, datë 05.08.2008.

Kontrata do t’i akordohet atij organi që ka dorëzuar ofertën e vlerësuar si më e mira, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë dokumentacion.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave me përfaqësuesit e tyre ligjorë ose me personat e autorizuar me autorizimin përkatës, shoqëruar me dokument identifikimi.

Mbetemi në pritje të ofertave tuaja,
Faleminderit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KLEVIS HYSA

SEKSIONI : LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3 :Formulari i Deklaratës mbi konfliktin e interesit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga organi i masmedias/agjencia e specializuar)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Objekti i procedurës :

Për: **[Organi i masmedias/Agjencia e specializuar shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Organi i masmedias/Agjencia e specializuar shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për ftesën e negocimit si dhe dokumentacionin e përcaktuar në ftesë për procedurën me objekt:*[shënoni objektin e ftesës për negocim të publikuar në faqen zyrtare të AKPA]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Organi i masmedias/Agjencia e specializuar dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në ftesën për negocim *[vendos objektin e ftesës për negocim të procedurës]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me ftesën për negocim si dhe dokumentacionin e përcaktuar në ftesë (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni objektin e procedurës përkatëse nga Njoftimi i ftesës për negocim të publikuar në faqen zyrtare të AKPA]** në përputhje me kushtet e përcaktuara, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në ftesën për negocim.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
- 1.Ftesën për Negocim;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Termat dhe kushtet e përcaktuara në ftesë;
 5. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Organi i masmedias/Agjencia e specializuar e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Organi i masmedias/Agjencia e specializuar e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | |
| Nënshkrimi | |
| Vula | |
| Datë _____ | |

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Objekti i procedurës _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Organi i medias/Agjencia e specializuar (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen si vijon:

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përrjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>5</i> | |
|---|-------------------------------|--------------|------------------------|---|-------|
| Artikulli | Përshkrimi i shërbimit | Sasia | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim (3 x 4X) | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| Çmimi total (Shërbimet) | | | | | _____ |
| Çmimi Neto pa TVSH | | | | | |
| TVSH (%) | | | | | |
| Çmimi total me TVSH: | | | | | |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | | | | | |
| Nënshkrimi | | | | | |
| Vula | | | | | |
| Datë _____ | | | | | |

Shtojca 3.

DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e Organit të masmedias/Agjencisë së specializuar, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____